



**Datë:** 13.05.2025  
**Numër Protokolli:** 4975/2025

**A.nr.649/2025**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.649/2025, të datës 15.04.2025, të parashtruar nga ankuesi A.I, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 13.05.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.649/2025, e datës 15.04.2025, e parashtruar nga ankuesi A.I.

**II. Anulohet** Konkursi me Nr.Ref:RN00017485, për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit i shpallur më datë 25.03.2025 nga Ministria e Punëve të Brendshme.

**III. Obligohet** Komisioni i Pranimit i themeluar sipas Vendimit më Nr.2067/2024, të datës 09.12.2024, të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të vazhdoj procedurën e pranimit me nr.ref: RN00015500 nga fazën e vlerësimit të testit me shkrim.

**IV. Detyrohet** Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi ashtu sikurse është përcaktuar në pikën II dhe III të dipozitivit.

**V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, A.I (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 15.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së pranimit më nr.ref: RN00017485, pozita Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, më datë 16.04.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme (tutje referuar MMPB), ndërsa, kjo e fundit, më datë 25.04.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

***Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit), vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova:*** Ankesën me numër protokolli 2479/2025 të parashtruar nga ankuesi më datë 15.04.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me Nr. Reference: RN00015500 të datës 17.10.2024, për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit; Njoftimin e datës 13.12.2024 nga Personeli i MPB-së për mbajtjen e testit me shkrim; Njoftimin e datës 29.11.2024 për verifikim paraprak; Njoftimin e datës 16.12.2024 nga Personeli i MPB-së për shtyrje të afatit të testit me shkrim; Vendimin me Nr. 2123/2024 i datës 16.12.2024 për shtyrje të afatit të testit me shkrim; Dëshmi nga SIMBNJ për statusin e konkursit; Konkursin me Nr. Reference: RN00017485 të datës 25.03.2025, për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 16.04.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 25.04.2025; Listën e aplikantëve; Vendimin me Nr. 2067/2024 të datës 09.12.2024 për emërimin e Komisionit të Pranimit; Vendim për pushim vjetor i datës 11.12.2024.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e ankuesit ***është e bazuar, sepse:***

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se:

- MPB-ja më datë 17.10.2024, ka shpall konkursin me nr.ref: RN00015500, për pozitën *Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit*, i hapur për aplikim nga data 18.10.2024 deri më datë 16.11.2024.
- Në konkursin nr.ref: RN00015500, ka aplikuar edhe ankuesi i cili ishte përfshirë në listën e verifikimit paraprak, si kandidat që ka plotësuar kushtet për pozitën e shpallur.

- Sekretarja e Përgjithshme e MPB, më Vendimin Nr. 2067/2024, të datës 09.12.2024, ka themeluar Komisionit ad hoc për vlerësimin profesional të kandidateve për pozitën *Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit*, në përbërje si vijon: *1.D.H, Drejtore e Departamentit për Shërbime të Përgjithshme-kryesues, zëvendësues, K.G, Udhëheqës i Divizionit për Sigurimin e Aviacionit Civi,; 2. M.H, Drejtor i Departamentit për Siguri Publike, anëtar, zëvendësues F.S, Udhëheqëse e Divizionit për Bashkëpunim me Organizata Vendore dhe Ndërkombëtare; 3.Sh.H, Udhëheqës i Divizionit për Buxhet, anëtar-zëvendësues A.Q, Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa; 4. B.S, Zyrtare e Lartë e Personelit, anëtare, zëvendësues B.Sh, Zyrtare e Lartë e Personelit dhe 5. F.Th, Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit, anëtar, zëvendësues R.I-R, Zyrtare e Lartë për Menaxhimin e Kontratave.*

- Më datë 13.12.2024, Zyra e Personelit të MPB-së, ka njoftuar kandidatët e listës së verifikimit paraprak se testi me shkrim për pozitën e cekur si më lartë është caktuar të mbahet me datë 16.12.2024 nga ora 14:30, ndërsa, më datë 16.12.2024, Njësia e Personelit të MPB, ka njoftuar kandidatët e verifikimit paraprak se testi me shkrim shtyhet për shkak të pamundësisë së pjesëmarrjes së anëtarëve të Komisionit të Pranimit të përcaktuar si në pikën 1.4 të Vendimit Nr.2067/2024, datës 09.12.2024, gjegjësisht si arsye specifikon gjendjen jo të mirë shëndetësore te tyre.

- Më datë 16.12.2024, Komisioni i Pranimit në MPB ka nxjerr Vendim me Nr. 2123/2024 me të cilin ka bërë shtyrjen e testit me shkrim për 15 ditë, për shkak të pamundësisë së mbajtjes së tij për arsye të gjendjes jo të mirë shëndetësore të anëtarëve sipas pikën 1.4 të përcaktuar si në Vendimin me Nr. 2067/2024.

-Më datë 25.03.2025, MPB shpall konkursin publik me Nr. Reference: RN00017458, për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit, i hapur për aplikim nga data 26.03.2025 deri më datën 24.04.2025.

Ankuesi më datë 15.04.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër shpalljes së konkursit me Nr. Reference: RN00017485, të datës 25.03.2025 për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit, duke pretenduar se nuk ka mundur të shpallet konkursi i ri pa përfunduar konkursi Nr. Reference: RN00015500 i datës 17.10.2024, ngase, nuk është njoftuar me asnjë njoftim nga MPB lidhur me këtë proces. Kërkon që konkursi me Nr. Reference: RN00017485, të pezullohet/anulohet dhe të detyrohet Personeli i MBP-së të përmbyll procesin e filluar më datë 17.10.2024 dhe të mbahet testi me shkrim.

Kolegji i Këshillit, në përmbushje të mandatit kushtetues dhe ligjor për sigurimin dhe respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, si dhe me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me theks të veçantë:

- **Neni 7, paragrafi 1:** [Parimet e pranimit në detyrë të zyrtares/it publik] *1. Pranimi në detyrë i nëpunëses/it civil, nëpunëses/it së shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it së artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknik dhe mbështetës, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese.*

- **Neni 39, paragrafi 1:** *1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj.*

- **Neni 45 paragrafi 2:** *2. Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunëse/ës civil ekzistues të kategorisë së njëjtë apo më të lartë; 2.2. një (1) nëpunëse/ës civil nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunëse/ës civil me njohuri në fushën e pozitës së lirë.*

- **Neni 46 paragrafi 1:** *1. Kandidatja/i për pozitën e nivelit të ulët apo të mesëm drejtues, e/i vlerësuar nga komisioni i pranimit me pikët më të larta dhe mbi pragun minimal të shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohet candidate/at fitues dhe emërohet në pozitën përkatëse për një mandat me kohëzgjatje prej katër (4) vitesh me të drejtë vazhdimi pa konkurrim vetëm edhe për një mandat tjetër me kohëzgjatje të njëjtë.*

Rrjedhimisht, referuar përcaktimit ligjor si me sipër, Kolegji analizoj Vendimin me Nr. 2067/2024 të datës 09.12.2024 të Sekretares së Përgjithshme e MPB, për emërimin e Komisionit ad hoc për vlerësimin profesion për pranim dhe konstatoj se përbërja e Komisionit të Pranimit në procedurën përkatëse të pranimit ka qenë në pajtim me kërkesat ligjore, të përcaktuara sipas nenit 45 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Organi i punësimit anulimin e konkursit më nr.ref. RN00015500, e arsyeton me sqarimin se: *...anëtari i komisionit të pranimit sipas Vendimin me Nr. 2067/2024 të datës 09.12.2024 (pra zj. B.S) ka qenë në pushim vjetor ndërsa anëtarja zëvendësues (znj. B.Sh) përmes thirrjes telefonie ka njoftuar se i është përkeqësuar gjendja shëndetësore, dhe për këtë arsye kemi njoftuar kandidatët se testi me shkrim shtyhet, tuje sipas kësaj përgjigje njofton se NJMBNJ më pas ka përgatitur njoftimin për anulim të konkursit, mirëpo për shkak të disa pengesave në sistem dhe angazhimeve të shumta, nuk kemi mundur të bëjmë njoftimin për anulimin e konkursit, dhe për shkak që pozita është me ushtrues detyre e kemi shpallur konkursin më datë 25.03.2025.*

Rrjedhimisht, bazuar në analizimin e provave të lëndës, Kolegji konstaton së anulimi i konkursit mbi arsyet sikurse në përgjigjen në ankesë, nuk përbën shkak ligjor dhe të pranueshëm për anulim, sepse, sipas Vendimit Nr.2067/204 të datës 09.12.2024, për emërimin e Komisionit të Pranimit, gjegjësisht sipas pikë 2 të dispozitivit të këtij vendimi, anëtarët dhe zëvendës anëtarët e Komisionit të Pranimit, kanë qenë në dijeni më detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Rrjedhimisht, është fakt i pakontestueshëm së me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 2067/2024 të datës 09.12.2024, anëtarja me nr. rendor 1.4, ka qenë në pushim vjetor me periudhë të aprovuar prej datës 12 deri 20 dhjetor 2024, mirëpo, duke qenë se njësia e personelit ka njoftuar kandidatet për mbajtjen e testit me shkrim më datë 16.12.2024, atëherë, anëtarja zëvendësues B.Sh, “ *de jure* ”, duhej të merrte pjesë në Komision të Pranimit, dhe se arsyen e mospjesëmarrjes së saj në testin me shkrim organi i punësimit nuk e ka argumentuar me asnjë provë mjekësore që konstaton gjendjen jo të mirë shëndetësore të saj. Për me tepër në vlerësimin e Kolegjit në testin me shkrim nuk është e domosdoshme pjesëmarrja e gjithë anëtareve të Komisionit, ashtu sikurse kjo pjesëmarrje është e detyrueshme në intervistën me gojë.

Me tej, në vlerësimin e Kolegjit, Komisioni i Pranimit ka nxjerrë Vendimin me Nr. 2123/2024, të datës 16.12.2024, e sipas të cilit akt fare nuk vërtetohet autori i nënshkrimit, pasi akti përmban vetëm një nënshkrim të pa identifikueshëm dhe nuk evidentohet emiri i nënshkruesit, e më të cilin vendim ishte shtyre afati për testimin me shkrim edhe për 15 ditë, çka rezulton së afati i fundit për mbajtjen e testit me shkrim ka qenë 30.12.2024, ndërsa anëtarja B.S është kthyer në punë më datë 23.12.2024 (*data 20-22.12.2024 ka qenë ditë vikendi*) dhe sipas kësaj janë plotësuar kushtet ligjore për mbajtjen e testit. Rrejdhimisht, pas vendimit të datës 16.12.2024, për shtyrje të testit me shkrim, organi i punësimit nuk ka ndërmarr asnjë veprim tjetër administrativ lidhur me procedurën e kontestuar, gjegjësisht, nuk ka dëshmi se kandidatët sipas listës së verifikimit të jenë njoftuar më mbajtjen e testit me shkrim dhe se nuk ka dëshmi nëse konkursi ishte anuluar dhe kandidatet të jenë njoftuar lidhur me këtë fakt, veprime këto që në vlerësimin e Kolegjit cenojnë të drejtat e palës ankuese si dhe kandidateve tjerë në këtë procedurë, dhe bien ndesh më parimet bazë të procedurës administrative të përcaktuara më Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me theks të veçantë:

**- Nenin 4 : Parimi i ligjshmërisë** 1. *Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.* 2. *Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj.* 3. *Nëse ligji autorizon organin publik të ushtrojë pushtet diskrecionar në një vendimmarrje (në vijim “diskrecioni”), ai do të ushtrohet në mënyrë të ligjshme vetëm nëse plotësohen këto kushte: 3.1. nuk tejkalon kufijtë e përcaktuar në ligjin që lejon diskrecionin; 3.2. zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin për të cilin ligji e parashikon diskrecionin dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Ligji, në veçanti me parimin e proporcionalitetit, dhe 3.3. zgjedhja e organit publik nuk është në kundërshtim me normat e gjithëpranuara të shkencës apo teknikës dhe nuk shkel parimet themelore të drejtësisë apo arsyes njerëzore.* 4. *Pushteti diskrecionar, përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, është mundësia që i jepet një organi publik, shprehimisht apo që nënkuptohet me ligj, për të vendosur duke zgjedhur në mes dy apo më shumë veprimeve të ligjshme, për t’i shërbyer në mënyrën sa më të përshtatshme interesit publik.*

**- Nenin 5: Parimi i proporcionalitetit** 1. *Një veprim administrativ, që për arsye të mbrojtjes së interesit publik kufizon apo cenon të drejtat apo interesat juridike të një personi, duhet të jetë në pajtim me parimin e proporcionalitetit.* 2. *Një veprim administrativ është në pajtim me parimin e proporcionalitetit vetëm nëse i plotëson këto kushte: 2.1. është i domosdoshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj; 2.2. është i përshtatshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj, dhe 2.3. kufizimi apo cenimi i të drejtës apo interesit juridik nuk është në shpërpjestim me realizimin e qëllimit të ndjekur.*

- **Neni 6: Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit** 1. Organi publik vepron në pajtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. 2. Personat në të njëjtën situatë trajtohen në mënyrë të njëjtë. Dallimi në trajtimin e çështjeve justifikohet vetëm nëse dhe për aq sa ai përputhet me ndryshimet objektive të çështjeve përkatëse. 3. Organi Publik, në mënyrë të veçantë, shmang çdo diskriminim të padrejtë ashtu siç përcaktohet me Ligjin kundër diskriminimit.

- **Neni 8: Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme** 1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave. 2. Një veprim administrativ nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustificuar nga një praktikë administrative e mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta a të ngjashme.

Andaj, nisur nga konstatimet si me sipër, rezulton së MPB-ja nuk ka mundur që të rihap procedurë të re për pozitë të njëjtë përderisa procedura e parë nuk ka përfunduar me vendim definitiv, dhe së MPB-ja me pranim të njoftimit për parashtrimin e ankesës nga ankuesi, ka qenë e detyruar që të pezulloj konkursin publik me Nr. Reference: RN00017458, dhe si pasojë Këshilli me vet kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 16.04.2025, e në kuptim të nenit 144 paragrafi 1 të LPPA-së, kishte kërkuar nga MPB pezullimin e çdo veprimi në kuadër të procedurës së pranimit më nr.ref: N00017458, andaj, mbi bazën e këtyre të gjeturave dhe konstatimeve, e në kuptim të nenit 18, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrejdhimisht, Këshilli aprovoj ankesën tërësisht si të bazuar, anuloi Konkursin Nr.Ref: RN00017485, për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit i shpallur më datë 25.03.2025 nga Ministria e Punëve të Brendshme si dhe detyroj Komisionin e Pranimit të themeluar sipas Vendimit më Nr.2067/2024, të datës 09.12.2024, të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të vazhdoj procedurën e pranimit me nr.ref: RN00015500 nga fazën e vlerësimit të testit me shkrim.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.649/2025

**Avdyl BEKTESHI**

Procesmbajtës

**Ardita Haxhnikaj DEMI**

Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit A.I;
- MPB-së: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Personelit
- Arkivit të KPMSHCK-së